REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNICE

KËSHILLI KONSULTATIV PËR KOMUNITETE
CONSULTATIVE COUNCIL FOR COMMUNITIES
KONSULTATIVNO VEĆE ZA ZAJEDNICE

PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2026

Plani Vjetor i Punës së KKK-së, përcakton angazhimet dhe masat për realizimin e objektivave të Këshillit Konsultativ për Komunitete, të cilat lidhen me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Ky plan është i ndarë në disa komponentë dhe ka disa elementë të rëndësishme, siç janë: Qëllimi, mekanizmat e implementimit dhe koordinimit, si dhe sfidat dhe rreziqet që mund të hasen gjatë realizimit.

1. Qëllimi

Plani Vjetor i Punës në mënyrë të detajuar përcakton të gjitha veprimet të cilat duhet të ndërmerren për t'i arritur objektivat e vëna strategjike për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjestarëve të tyre. Në këtë Plan Vjetor të Punës, gjithashtu, identifikohen bartësit, orari kohor dhe kërkesat buxhetore për zbatimin e secilës masë dhe aktivitet.
Me miratimin e Planit Vjetor të Punës, Këshilli dhe Sekretariati i Këshillit, merr përsipër angazhimet dhe përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e këtij plani.

Plani Vjetor i Punës është bazuar në objektivat e përgjithshme, caqet dhe pikat e referencës që janë përcaktuar dhe dalin nga Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtava të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, programet dhe dokumentet tjera Strategjike kushtuar promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteteve dhe pjestarëve të tyre në Republikën e Kosovës, dhe të cilat në Planin e Punës, ato më aktualet dhe më kryesoret, janë zbërthyer në masa dhe aktivitete konkrete.

Plani Vjetor i Punës, trajton tri (3) fusha kryesore që ndërlidhen me objektivat e përgjithshme, siq janë prezantuar në pikën pesë (5) të këtij Plani.

Ky Plan Vjetor i Punës i përshtatet rrethanave, nevojave dhe mundësive buxhetore të Këshillit, pas gjashtë (6) mujorit të parë raportohet për rrjedhat e implementimit të tij, si dhe mundë të rishqyrtohen veprimet dhe aktivitetet e planifikuara.

2. Mekanizmat e implementimit, koordinimit dhe raportimit
Me zbatimin e Planit Vjetor të Punës, nën mbikëqyerjen e Kryesisë do të merren kryesisht grupet punuese, sipas fushave përkatëse, të asistuara nga stafi i Sekretariatit.

3. Rreziqet dhe sfidat në implementimin e Planit Vjetor të Punës
Sfidat dhe rreziqet në implementimin e Planit Vjetor të Punës mund të jenë:

1. Mungesa e pajisjeve dhe hapësirës së mjaftueshme për punë;
2. Angazhimi jo i mjafueshëm në përmbushjen e planit vjetor të punës.

4. Shpjegime për Planin Vjetor të Punës

Plani Vjetor i Punës	Përcakton konkretisht objektivat, masat, aktivitetet, afatet për përmbushjen e tyre, institucionet dhe zyrtarët përgjegjëse për zbatim. Gjithashtu, në kuadër të planit paraqiten komentet për referencat e dokumenteve zyrtare apo komente tjera, afatet, si dhe rreziqet dhe buxheti i nevojshëm për implementim.
Objektivat e përgjithshme	Këtu paraqiten objektivat e përgjithshme të cilat duhet të arrihen me zbatimin e Planit Vjetor të Punës. Objektivat përfshihen brenda fushave të përcaktuara, siç janë definuar në pikën pesë (5) të këtij Plani Vjetor të Punës
Masat (Caqet)	Paraqesin objektivat specifike të punës të identifikuara për përmbushje përmes realizimit të veprimeve dhe aktiviteteve të planifikuara.
Aktivitetet/ veprimet	Aktivitetet nënkuptojnë masat konkrete të cilat duhet ndërmarr dhe zhvilluar me qëllim të konkretizimit dhe zbërthimit të veprimeve përkatëse. Paraqesin aktivitetet e përgjithshme për arritjen e objektivave specifike dhe shërbejnë për të arritur objektivin strategjik të dhënë në fillim të çdo fushe të caktuar.
Pikat e referencës (indikatorët e verifikueshëm)	I referohen treguesve konkretë të suksesit që duhet të arrihet brenda kohës së caktuar në fushat e përcaktuara. Indikatorët e suksesit lidhen me aktivitetet dhe veprimet të cilat janë të dhëna në tabela.
Institucionet dhe zyrtarët përgjegjës	Paraqet institucionin, njësinë organizative, grupet e punës dhe zyrtarët përgjegjës të cilët janë përgjegjëse për zbatimin e masave, aktiviteteve dhe veprimeve të caktuara.
Buxheti, Kostoja Financiare	Paraqet burimin e buxhetit nga i cili masat e parashikuara janë planifikuar të financohen, si dhe vlerësimin e kostos financiare për aktivitete të cilat kanë implikime buxhetore.

Komentet, Rreziqet dhe supozimet	Paraqet ndonjë koment eventual për veprimin, sfidat dhe rreziqet që paraqiten gjatë zbatimit të masave dhe aktiviteteve.
Afatet kohore	Koha e parashikuar kur masat dhe aktiviteti përkatës duhet të jetë i kompletuar.

5. IMPLEMENTIMI I PLANIT VJETOR TË PUNËS

Vizioni

Një mekanizëm funksional, efektiv dhe i qëndrueshëm në gjendje për të përfaqësuar dhe për të adresuar nevojat, pikëpamjet dhe interesat e të gjitha komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Misioni

Misioni i Këshillit është që, si një mekanizëm për konsultim, bashkërendim dhe shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore, t'ju ndihmoj komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në realizimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, si dhe sigurimin e qasjes dhe pjesëmarrjen në jetën: politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë.

Objektivat e përgjithshme të punës:

1. Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e shtetit në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për komunitetet;
2. Thellimi i bashkëpunimit me institucionet e nivelit qendror, lokal dhe sektorit joqeveritar me rëndësi për komunitetet;
3. Informimi i përhershëm dhe me kohë i publikut me punën dhe aktivitetet e Këshillit;

OBJEKTIVI 1:

Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e shtetit në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për komunitetet;

MASAT	AKTIVITETET	INSTITUCIONET, ZYRTARËT PËRGJEGJËS	AFATET T1-T4	PIKAT E REFERENCËS, FAZA E REALIZIMIT DHE TË ARRITURAT KRYESORE	KOMENTE, RREZIQET DHE SUPOZIMET	BUXHETI[1]
1. Organizimi dhe artikulimi i pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre ne lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to.	1. Të kërkohen dhe sigurohen nga Zyret përkatëse pranë Zyrës së Kryeministrit Programi Legjislativ dhe Plani i Dokumenteve Strategjike për vitin 2026. 2. Identifikimi dhe përcaktimi i projektligjeve dhe projektstrategjive të cilat kanë rëndësi për komunitetet për shqyrtim në fazën	➢ Sekretariati i Këshillit ➢ Grupet punues të Këshillit	T1-T4	✓ Pranimi i Programit Legjislativ ✓ Plani i Dokumenteve Strategjike. ✓ Identifikimi i Projektligjeve dhe ✓ Identifikimi i Projektstrategjive për shqyrtim nga Këshilli	○ Vonesa në miratimin e Programit Legjislativ dhe Planit të Dokumenteve Strategjike. ○ Mungesa e bashkëpunimit me ZKM-në dhe ZPS.	Buxheti Këshillit

	e konsultimeve parprake dhe konsultimeve publike në grupet punuese dhe në Këshill. 3. Pranimi, shqyrtimi dhe dhënia e komenteve me kohë në projektligjet projekt strategjitë dhe aktet e tjera normative me rëndësi të veçantë për komunitetet. 4. Ndryshimi dhe Plotësimi i Statutit të Këshillit. 5. Vizitat studimore.					

2. Përcjellja e përhershme lidhur me përfshirjen e komenteve në nismat legjislative të dërguara nga ana e Këshillit.	1. Hartimi dhe dërgimi me kohë i komenteve në nismat legjislative. 2. Kontaktimi i zyrtarëve përgjejgës në institucione që i janë dërguar komentet. 3. Marrja e përgjigjeve kthyese nga zyrtarët përgjejgës për përfshirjen apo arsyen e mospërfshirjes së komenteve.	➢ Grupet punuese ➢ Sekretariati i Këshillit	T1-T4	✓ Janë përpiluar dhe janë dërguar me kohë komentet	○ Vonesat në përpilimin dhe dërgimin e komenteve nga grupet punuese dhe nga Këshilli; ○ Mosmarrja e përgjigjes nga institucionet kompetente për rekomandimet e dërguara	Buxheti i Këshillit

OBJEKTIVI 2: Thellimi i bashkëpunimit të Këshillit me institucionet e nivelit qendor, lokal dhe sektorit joqeveritar me rëndësi për komunitetet.						
MASAT	AKTIVITETET	INSTITUCIONET,ZYRTARËT PËRGJEGJËS	AFATET T1-T4	PIKAT E REFERENCËS, FAZA E REALIZIMIT DHE TË ARRITURAT KRYESORE	KOMENTE, RREZIQET DHE SUPOZIMET	BUXHETI[2]
1. Shkëmbimi i rregullt i Këshillit me institucionet në nivelin qendror dhe atë lokal;	1. Ftuarja e përfaqësueseve të institucioneve nga niveli qendror dhe lokal, për të marrë pjesë në takimet e Këshillit, në takimet e grupeve punuese si dhe në tryezat apo konferencat e organizuara nga Këshilli dhe grupet punuese të Këshillit.	➢ Këshilli ➢ Grupet punuese ➢ Sekretariati i Këshillit	T1-T4	Ftuarja me kohë e përfaqësuesve të institucioneve në takimet e Keshillit dhe te grupeve punuese të Keshillit Kërkimi me kohë i informatave dhe i të dhënave nga institucionet	Mosftuarja me kohë e përfaqësueseve të institucioneve në takime dhe mospërgjigja e tyre ndaj ftesave të Këshillit.	Buxheti i Këshillit

[2]

	2. Kërkimi i informatave dhe i të dhënave nga institucionet që janë me rëndësi për komunitetet. 3. Pjesëmarrja e anëtarëve të Këshilit në grupet punuese, konferencat apo tryezat e rrumbullakta te organizuara nga Institucionet relevante ne nivelin qendror dhe lokal. 4. Shënimi i ditëve të veçanta për komunitetet (ditët memoriale të komuniteteve, ditët e gjuhëve dhe ditët e tjera të rëndësishme për komunitetet) 5. Takimi me përfaqësuesit e pushtetit lokal.		T1-T4			

2. Bashkëpunimi me organizatat përfaqësuese të komuniteteve.	1. Organizimi i nga një (1) takimi në vit, në mes të përfaqësueseve të secilit komunitet në Këshill me organizatat përfaqësuese të komuniteteve përkatëse, pjesëmarrës në	Anëtarët e Këshillit Sekretariati i Këshillit	T1-T4	Organizimi i takimeve		Buxheti i Këshillit

	procesin e nominimit për anëtarë në Këshill.					

OBJEKTIVI 3: Informimi i përhershëm dhe me kohë i publikut me punën dhe aktivitetet e Këshillit						
MASAT	AKTIVITETET	INSTITUCIONET,ZYRTARËT PËRGJEGJËS	AFATET T1-T4	PIKAT E REFERENCËS, FAZA E REALIZIMIT DHE TË ARRITURAT KRYESORE	KOMENTE, RREZIQET DHE SUPOZIMET	BUXHETI[3]
1. Publikimi i rregullt i aktiviteteve të Këshillit	1. Përpilimi dhe publikimi i komunikatave nga takimet e Këshillit dhe të grupeve punuese. 2. Përpilimi dhe publikimi i komunikatave nga aktivitetet që i realizon kryesuesi, kryesia, grupet punuese	➢ Sekretariati i Këshillit ➢ Zyrtari për komunikim	T1-T4	✓ Janë përpiluar dhe publikuar me kohë komunikatat për aktivitetet e realizuara.	Vonesa në përpilim dhe publikim. Mosinteresimi i mediave.	Buxheti i Këshillit

	apo anëtarët e Këshillit. 3. Publikimi i Planit Vjetor të Punës. 4. Publikimi i Raporit Vjetor të Punës.					